



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|-----------------------|--|------------------------------|------------------|
| Agnese Ibrahim | 25.04.2024 | 15.05.2024 | 2024/0335 |
| Eksperti Teknik | Data e autorizimit të ekspertit teknik | | |
| Zeni Ballazhi | 30.04.2024 | | |

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.04.2024, OE “Sabit Makiqi B.I.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0335, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE “Emreus SHPK, Seyntex, Boulevard SHPK”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE” me nr. të prokurimit: "214-23-8647-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 11,351,852.00 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 15/08/2023

Hapja e ofertave: 26/12/2023

Vendimi i AK-së: 25/03/2024

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0335 i dt:17.04.2024. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ankesa me numër 2024/0335, e cila mund të gjendet në faqen e OSHP-së.

KRITERET PËR VLERËSIM



| | |
|--|--|
| <p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p> <p>a) Per <u>Pjesen 1</u> Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjtë ose ngjashme profesionale si për shembull (uniforme Policore, uniforma Ushtarake, uniforma Zjarrfikëseve, uniforma Gardianeve, uniforma Doganierëve) gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e Korrigjimit te Njoftimit për kontratë) jo me pak se 5,000,000.00 €</p> | <p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi Listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate), të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca ose raporte të pranimit në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse, për furnizimet e realizuara dhe pranuar, te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e furnizimit dhe vendin e realizimit. • Kur furnizimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër (jashtë RKS), për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. • Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimit ose raportet e pranimeve. AK mban te drejtën e verifikimit te te gjitha referencave duke kërkuar dëshmi shtesë nëse ka dyshime ne lidhje me kontratat e realizuara.</p> |
|--|--|

| | |
|---|--|
| <p>b) Per dy (2) pjeset ;Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjtë ose ngjashme profesionale si për shembull (uniforme Policore, uniforma Ushtarake, uniforma Zjarrfikëseve, uniforma Gardianeve, uniforma Doganierëve) gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e Korrigjimit te Njoftimit për kontratë) jo me pak se 80,000.00 €</p> | <p>b) Per Pjesen 2 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi Listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate), të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca ose raporte të pranimit në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse, për furnizimet e realizuara dhe pranuar, te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e furnizimit dhe vendin e realizimit. •Kur furnizimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër (jashtë RKS), për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. • Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimit ose raportet e pranimeve. AK mban te drejtën e verifikimit te te gjitha referencave duke kërkuar dëshmi shtesë nëse ka dyshime ne lidhje me kontratat e realizuara.</p> |
| <p>c) Per dy (2) pjeset Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 : 2015 ose 9001 :2018</p> | <p>c) Kopje e Certifikatës ISO 9001:2015 ose 9001:2018 Certifikata duhet te posedojne linkun e faqes per verifikim online te validitetit te certifikatave!</p> |

| | |
|---|---|
| <p>d) Per dy (2) pjeset Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 14001 : 2008</p> | <p>d)) Kopje e Certifikatës ISO 14001 : 2008 Certifikata duhet te posedojne linkun e faqes per verifikim online te validitetit te certifikatave!</p> |
| <p>e) Per dy (2) pjeset për secilin artikull siç është specifikuar ne Aneksin1. Duhet te deshmohen Atestet. Atestet duhet te jenë nga laboratorit i cili është i certifikuar sipas ISO 17025 2005. Se bashku me ateste duhet te dorëzohet edhe kopja e certifikatës ISO 17025 2005 e laboratorit ku është bërë testimi, atestet duhet te permbajn te dhenat e laboratorit, si numrin kontaktues, email adresen elektronik. Atestet duhete te jene ne gjuhete zyrtare.</p> | <p>e) Kopje te raporteve testuese dhe kopja e certifikatës ISO 17025 2005 se laboratorit Certifikata duhet te posedojne linkun e faqes per verifikim online te validitetit te certifikatave!</p> |
| <p>ë) Per dy (2) pjeset Deklarate nga prodhuesi për garancion për periudhën prej 12 muaj për të gjitha artikujt, me titull dhe numër te projektit</p> | <p>ë) Deklaratë nga prodhuesi për garancion - origjinal kopje noterizuar</p> |
| <p>f) Per dy (2) pjeset Ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë nga një mostër për secilin artikull sipas specifikacioneve teknike Aneksit 1 para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve në orën 14 00</p> | <p>f) OE duhet të dorëzojë nga një mostër për secilin artikull para afatit të fundit për pranimit të ofertave ora 14 00</p> |
| <p>g) Per dy (2) pjeset Deklarate nga OE qe do te bëjë matjen e secilit bartës te uniformes sipas nevojave te AK</p> | <p>g) Deklaratë e vulosur dhe nënshkruar nga kompania se bënë matjen sipas nevojave te AK</p> |

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

| |
|--|
| |
|--|

| | | |
|---|---|---|
|  | <p>Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs Policia e Kosovës / Policia Kosova / Kosovo Police Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/ Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate</p> |  |
|---|---|---|

| | |
|-----------|--|
| DATA | 08/04/2024 |
| PER/ZA/TO | Sabit Makiqi B.I |
| Cc | Fatmir Bajrami, Drejtor i Departamentit për Shërbime Mbështetëse |
| NGA | Artan Fejza, Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit |
| TEMA | Shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtim për "FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE" me nr. Prok.214-214-8647-1-1-1 nga: Sabit Makiqi B.I |

Në mbështetje të nenit 108/A pika 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 60 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik për parashtrimin ankesave të miratuar nga KRPP-ja, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të datës 29.03.2024 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik Sabit Makiqi B.I si pale të interesuar për aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE" me nr. Prok.214-214-8647-1-1-1, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, nxjerr këtë:

VENDIM
MBI REFUZIM TË KERKESËS PËR RISHQYRTIM TË PARASHTRUAR NGA OE
SABIT MAKIQI B.I të datës 29.03.2024

- I. Refuzohet kërkesa për rishqyrtim e PA BAZUAR nga SABIT MAKIQI B.I të datës 29.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE" me nr. Prok.214-214-8647-1-1-1, iniciuar nga Policia e Kosovës.
- II. Mbetet në fuqi vendimi AK - Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE" me nr. Prok.214-214-8647-1-1-1, dhe AK Policia e Kosovës vazhdon me tutje aktiviteti sipas LPP-se.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Sabit Makiqi B.I.**

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë si palë e pakënaqur ndaj vendimi të AK-së. Përgjigje në pretendimet ankimore të ngritura kanë dhënë eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik.

Përgjigje ne pretendimin e parë

Pas pretendimit të ngritur nga OE ankues sa i përket qasjes së kufizuar në dokumente të operatorit të rekomanduar, eksperti shqyrtues sqaron se pas kërkesës së bërë për qasje në ofertën e OE i rekomanduar, i është ofruar një qasje shumë e kufizuar për shkak që sipas AK-së, njëri nga anëtarët e GOE i rekomanduar ka plotësuar Aneksin 3, përmes të cilit ka kërkuar që dokumentet të cilat kanë të bëjnë me aspektin financiar dhe ekonomik dhe ato me aftësitë teknike dhe profesionale janë deklaruar që të mbesin sekret afarist. Kështu, AK ka lejuar qasjen e OE ankues vetëm në disa dokumente siç janë: certifikatat e biznesit, deklaratat nen betim, formulari i tenderit, lista e cmimeve-paramasa dhe parallogaria, kërkesa e konfidencialitetit dhe mostrat. Neni 10 dhe neni 11 i Ligjit për Prokurimin Publik, lejojnë qasje nga palët e interesuara në ofertat e dorëzuara përmes një kërkesë me shkrim të bërë nga ajo palë, ku lejohet qasja në të gjitha dokumentet përveç atyre që janë deklaruar si sekret afarist nga ana e Operatorëve Ekonomik, por me kusht që këto të dhëna të vërtetohen si të tilla edhe nga ana e Autoritetit përkatës.

Sipas ekspertit shqyrtues jo të gjitha dokumentet në një ofertë mund të cilësohen si sekret afarist, sipas nenit 11 të Ligjit për Prokurimin Publik, ky nen thotë që AK duhet të përgatitë një version të pastruar, përmes të cilit AK duhet të bëjë ndarje se cilat të dhëna mund të konsiderohen si sekrete afariste dhe cilat jo. Duke u bazuar edhe në nenin 7 të Rregullores për Prokurimin Publik, përkatësisht pika 7.6, b thotë se: Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 “Kërkesa për sekret afarist”, të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të idetifikuar si “sekret afarist”, nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij. Po ashtu neni 7 i RRPP-së, pika 7.3 po ashtu thotë se: *Pas publikimit të rezultatit mbi vendimin e AK vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe të pranuar nga AK si sekrete të biznesit do të mbesin sekrete për të gjitha palët duke përfshirë KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente.* Pra sipas Legjislacionit në fuqi, dokumentet të cilat deklarohen si sekrete

afariste nga ana e Operatorëve Ekonomik, të njëjtat cilësohen të tilla vetëm pasi të jenë të pranuar si sekrete afariste edhe nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Nga kjo çfarë u sqarua më lartë, eksperti vlerëson që AK duhet të krijoj një version të pastruar të dokumenteve, sekret afarist duhet të mbesin të gjitha ato dokumente apo të dhëna për të cilat edhe vet AK është bindur se me të vërtetë, shpërndarja e tyre tek operatorët e tjerë, mund të shkaktojnë çfardo dëmi për OE i rekomanduar.

Përgjigje në pretendimin e dytë

Eksperti shqyrtues sqaron që OE i rekomanduar me ofertë ka dorëzuar a-testet për produktet e kërkuara sipas Aneksi 1, me kërkesat për sqarim OE i rekomanduar ka sjellë edhe dy a-teste të reja, me letër sqarim të sjellur nga laboratorit i testimit, Seyntex përmes këtij sqarimi pranon se a-testet e dorëzuara me numra të referencës SL517352920737TX, SL517352930340TX, SL517352920774TX dhe SL517352930368TX në mënyrë të rastësishme janë përzier nga furnizuesi i lëndës së parë dhe me këtë deklaratë për të njëjtat janë dorëzuar testet e reja por të cilat mbajnë data të cilat janë para datës së fundit për dorëzimin e ofertave siç kërkohet me LPP, në këtë mënyrë autoriteti ka pranuar këto teste dhe në këto teste rezultatet përkojnë me kërkesat e autoritetit sa i përket pambukut dhe poliesterit. Sipas nenit 72 të LPP-së, AK ka të drejtë të kërkoj informata shtesë duke plotësuar apo qartësuar certifikata apo dokumente të caktuara në pajtim me nenet 65-71 të ligjit për prokurimin publik. Duke marrë parasysh se përmes a-testeve vërtetohet cilësia dhe specifikat e caktuara të produkteve, andaj këto teste sipas nenit 70 të LPP-së mund të hyjnë në kategorinë e standardeve për sigurimin e cilësisë. Pra, sipas nenit 72 AK ka të drejtë të kërkoj sqarime shtesë për këto dokumente, gjithmonë duke u siguruar që data e lëshimit të tyre është brenda periudhave të parapara ligjore. Sa i përket pretendimit se a-testet e OE i rekomanduar janë manipuluar, eksperti thekson se nuk është person kompetent për të vërtetuar se a janë këto dokumente të manipuluar apo jo. Në këtë pikë konsiderojmë që pretendimi nuk është i bazuar. Sa i përket qasjes në dokumente, eksperti këtë pjesë e ka sqaruar në përgjigjen e pretendimit të parë.

Eksperti sqaron se Autoriteti Kontraktues nuk ka qenë i qartë në momentin e vendosjes së kërkesave sa i përket dorëzimit të certifikatave për ISO 17025:2005. Në FDT AK ka kërkuar nga operatorët pjesëmarrës që dorëzojnë dëshmi se janë të certifikuar me ISO 17025 për kryerjen e testeve laboratorike, ndërsa tek Aneksi I, AK shton se operatorët duhet të dorëzojnë edhe fushëveprimin e certifikatës, pra duke përfshirë të gjitha ISO standardet për të cilat është i akredituar ai laborator siç e cekë edhe autortiteti. Megjithëse këtë kërkesë, asnjëri nga operatorët përfshirë OE i rekomanduar dhe dy operatorët ankues nuk është parë se kanë dorëzuar fushëveprimin e certifikatës në ofertën e tyre, kjo e bënë që AK të këtë të vështirë vërtetimin e secilit ISO për secilin aspekt të artikujve të kërkuar. Po ashtu nga ana tjetër as AK nuk ka publikuar ndonjë listë të të gjitha ISO standardeve me të cilat duhet të jetë i akredituar laboratorit testues, që në të njëjtën kohë në kërkesat e DT-së, ka theksuar vetëm një standard me të cilin ka kërkuar të jenë të certifikuar labororet ku kryhen testimet e operatorëve. Këto

kërkesa të pa definuara mirë, duket se kanë sjellë paqartësi edhe tek operatorët por kanë sjellë vështirësi edhe për ekspertët në vërtetimin dhe verifikimin e testeve të dorëzuara.

Sipas kërkesave të DT-së, OE ankues ka dorëzuar a-testet për artikujt e kërkuar përfshirë edhe kapelën dhe pantollonat verore dhe dimërore. Sipas kërkesave të autoritetit për falltën ballore të pantolonave verore dhe dimërore për meshkuj dhe femra përmes Aneksi 1 është kërkuar të dorëzohet certifikata e cilësisë për vijën e hekurit ose raporti i testimi nga një laborator i pavarur dhe i akredituar dhe kjo dëshmi nuk është ofruar nga ana e operatorit ankues. Po ashtu edhe për shiritin e djersës pasqyrohet se nuk është dorëzuar a-testi përkatës, megjithatë, sipas nenit 72 të LPP-së dhe pikës 10 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik, AK ka mundur që të kërkoj sqarime shitesë sa i përket këtyre testeve të cilat mungojnë. Andaj, ky pretendim i ngritur vlerësojmë që është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e tretë

Sipas nenit 108/A të LPP-së, OE pjesëmarrës kanë të drejtë të dorëzojnë një kërkesë për rishqyrtim nëse ata mendojnë që të drejtat e tyre janë shkelur nga vendimi i autoritetit, autoriteti kontraktues duhet ta shqyrtojë kërkesën e parashtruar brenda tre ditë pune nga data e dorëzimit të kërkesës. Në raste specifike të justifikuara, ky afat mund të zgjatet për jo më shumë se tre ditë shitesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë. Në rastin konkret AK ka kthyer përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim pas 10 ditësh, përkatësisht gjashtë ditë pune pas dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim, sipas platformës e-prokurimi dhe deklaramit të operatorit ankues, AK nuk ka njoftuar operatorin ankues për shtyerje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim dhe një gjë e tillë kondiserojmë që nuk është në përputhje me nenin 108/A të LPP-së. Sa i përket pjesës së përgjigjeve në pretendime, eksperti sqaron se AK është përgjigjur në pretendimet e ngritura nga OE ankues, andaj ky pretendim vlerësojmë që është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e katërt

Sipas nenit 40 të Rregullores për Prokurimin Publik, autoriteti kontraktues duhet të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve brenda periudhës sa më të shkurtë të mundshme kohore por jo më shumë se 30 ditë që nga hapja e ofertave, përveç rasteve të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara ku kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shitesë prej 20 ditësh. Eksperti pasqyron që në rastin konkret AK ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së, 90 ditë që nga dita e hapjes së ofertave, e cila nuk është në përputhje me pikën 40.3 të nenit 40 të RRPP-së. Sa i përket pretendimit që AK qëllimisht ka tejkalluar afatet ligjore për të lidhur kontrata kundërligjor, eksperti sqaron se nuk është personi kompetent për të dëshmuar një dyshim të tillë. Vlerësojmë që në këtë pikë pretendimi i ngritur nga OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e pestë

Eksperti sqaron se pjesë e DT-së, tek Aneksi 1 është kërkuar që OE ofertues për a-testet e produkteve të kërkuara duhet të testohen në laboratore të akredituara dhe certifikuara me ISO 17025:2005, tutje AK thekson se duhet të dëshkohet se laboratorin në fjalë është i çertifikuar për të bërë testimet e kërkuara. OE ankues në ofertë ka dorëzuar certifikatën nga Instituti i akreditimit të Republikës së Maqedonisë Veriore, sipas kërkesave të AK-së, megjithatë mungon linku i faqes për verifikim online siç është kërkuar përmes dosjes. AK përmes e-mailit ka komunikuar me laboratorin në fjalë duke kërkuar disa sqarime sa i përket listës së materialeve/produkteve për të cilat ata janë të akredituar për të kryer testimet. Laboratori-Euromak Kontrol ka kthyer përgjigje se i ka kushtet për të kryer analizat laboratorike për të gjithë parametrat të cilat janë të listuar nga numri 30/23 deri 38/23, testet të cilat për këto parametra sipas këtij listimi janë të dorëzuara në ofertën e OE ankues. Tutje laboratorin sqaron se nuk është i akredituar për të gjitha metodat e ekzaminimit dhe nuk ka laboratorin e cili është i akredituar për të gjitha parametrat e specifikimeve teknike, megjithatë përmes e-mailit është shprehur se ka kapacitet për të ekzaminuar analizat për parametrat e kërkuar sipas pozicioneve të lartëcekura dhe se të njëjtat sipas raportit laboratorik janë ekzaminuar nga Euromak Kontrol si dhe për të njëjtat janë dorëzuar edhe testet. Sipas ekspertit, dëshmia e dorëzuar-certifikata e akreditimit të laboratorit nga institucioni gjegjës është në përputhje me kërkesat e AK-së, por mungon linku i verifikimit dhe lista e fushëveprimit. Ndërsa sa i përket a-testeve për artikujt të cilët mungojnë sipas Aneksi 1, eksperti sqaron se OE ankues nuk ka dorëzuar listën e fushëveprimit të certificates në të cilën do të përfshiheshin të gjitha ISO standardet për të cilat është i akredituar laboratorin edhe pse në këtë pikë sipas vlerësimit të ekspertit këto kërkesa ku përmes një liste duhet të sjellen të gjitha llojet e standardeve për të cilat janë akredituar laboratorin ku në anën tjetër në FDT është kërkuar certifikimi vetëm për një standard cilësie konsiderojmë që janë kërkesa të cilat nuk janë në përputhje me njëra tjetrën dhe madje krijojnë kufizim të pjesëmarrjes të operatorëve të interesuar ashtu siç e kërkon edhe ligji i prokurimit. Vlerësojmë që ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e gjashtë

Sipas DT-së nga operatorët pjesëmarrës është kërkuar që të dorëzojnë teste laboratorike (a-teste) për secilin artikull të përfshirë në Aneksi 1, OE ankues ka dorëzuar testet laboratorike nga një laboratorin i akredituar në shtetin e Maqedonisë Veriore duke dorëzuar edhe certifikatën e cila dëshmon akreditimin e këtij laboratorin me ISO standardin e kërkuar- ISO 17025:2018. Nga ky laboratorin janë lëshuar test raportet për artikujt e Aneksi 1, duke përfshirë edhe kapelën dhe pantollonat për stafin, por jo edhe testet për secilën pjesë të artikujve siç po kërkon autoritetin. Siç e kemi sqaruar në pretendimin paraprak edhe pse ka mos përputhje mes kërkesave të FDT-së dhe kërkesave për a-teste në Aneksi 1, operatori ankues është dashur të dorëzojë fushëveprimin bashkë me certifikatën e kërkuar përmes të cilës do të vërtetoheshin lehtë ISO standardet për të cilat është i akredituar laboratorin të kryej testimet përkatëse. Sa i përket pjesës tjetër se a-testet e OE i rekomanduar mund të jenë fiktive, joreale dhe të njëjtat

mund të kenë ndërhyrje fizike, eksperti siç e ka sqaruar edhe më herët në këtë raport, verifikimet e tilla i takojnë organeve kompetente dhe ne si ekspert nuk kemi mundësi profesionale për të bërë një verifikim të tillë. Ky pretendim konsiderojmë që është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e shtatë

Ekspertët sqarojnë se Autoriteti Kontraktues nuk ka hapur fare mostrat e operatorit ankues me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar aspektin e kriterëve kualifikuese siç është rasti i a-testeve të dorëzuara. Kështu që të vetmet mostra të cilat janë hapur nga ana e autoritetit janë vetëm mostrat e operatorit të rekomanduar. Për pjesën tjetër të a-testeve eksperti ka dhënë përgjigje në pretendimet më lartë.

Specifikimet teknike të verifikuara nga eksperti teknik sipas pretendimeve ankimore

Përgjigje në pretendimi ankimor 8:

1. JAKNA E DIMRIT-meshkuj

Shiritat për spaleta

Specifika teknike të verifikuara nga mostrat

Shiritat me maje të spaletave sipas verifikimit dhe matjeve të mostrave rezultojnë si më poshtë: 15.5 x 4 cm

Mbyllja e jaknes - Shiriti i përfundshëm (kanali i shiut) sipas verifikimit dhe matjes është: 2 cm

Gjatësia e shpinës sipas verifikimit dhe matjeve të madhësisë L-Regular është: 78.5 cm, kurse

Gjerësia e xhakëtës për meshkuj sipas matjes dhe verifikimit është: 56.5 cm

Jaka për madhësinë L-Regular për meshkuj sipas matjes dhe verifikimit është: 57 cm

Përgjigje në pretendimi ankimor 9:

2.JAKNA E VERËS - meshkuj

Shiriti për spaleta sipas verifikimit dhe matjeve të mostrave është: 15.5 x 4 cm

Mëngët për madhësinë L-regular sipas verifikimit dhe matjeve të mostrave janë: 7.5 cm

Shiriti i përfundshëm (kanali i shiut) sipas verifikimit dhe matjes është: 2 cm

Gjerësia e shpinës për meshkuj sipas matjes dhe verifikimit është: 56.5 cm

Përgjigje në pretendimi ankimor 10:

3.XHEMPERI (M-regular)

Hapja V sipas verifikimit dhe matjes është: 30 mm

Gjatësia totale sipas verifikimit dhe matjes është: 67.6 cm

Përgjigje në pretendimi ankimor 11:

4.PANATLLONAT E DIMRIT - meshkuj

Pjesa e poshtme e këmbës së pantallonave sipas verifikimit shiriti i fortë nga najlloni ndodhet jashtë por nuk është i çepur në pjesën e poshtme.

Shiriti i belit të pantallonave të dimrit dhe të verës sipas verifikimit dhe matjeve është: 1 mm komplet kurse pjesa e gomës 0.5mm

Përgjigje në pretendimi ankimor 12:

5.PANATLLONAT E VERËS - meshkuj

Pjesa e poshtme e këmbës së pantallonave sipas verifikimit shiriti i fortë nga najlloni ndodhet jashtë por nuk është i çepur në pjesën e poshtme.

Shiriti i belit të pantallonave të dimrit dhe të verës sipas verifikimit dhe matjeve është: 1 mm komplet kurse pjesa e gomës 0.5mm

Përgjigje në pretendimi ankimor 13:

6.KËMISHA ME MËNGË TË GJATA-meshkuj

Kapaku i xhepit sipas verifikimit dhe matjes është: 12.5 cm gjerësi dhe 14.5 gjatësi

Gjatësia e mëngës sipas verifikimit dhe matjes është: 66 cm

Gjatësia e këmishës sipas verifikimit dhe matjes është: 80 cm

Gjerësia e shpinës sipas verifikimit dhe matjes është: 48.5 cm

7.KËMISHA ME MËNGË TË SHKURTRA

Gjerësia e shpinës te krahët sipas verifikimit dhe matjes është: 48.5 cm

Gjerësia e shpinës sipas verifikimit dhe matjes është: 60 cm

Gjerësia e shpinës pjesa e poshtme sipas verifikimit dhe matjes është: 63 cm

Përgjigje në pretendimi ankimor 14:

8.KAPELA FEMRA

Shiriti dekorues sipas verifikimit dhe matjes është: 3.8 cm gjerësi

9.KAPELA MESHKUI

Kopse e kapelës sipas verifikimit: është me logon e Policisë së Kosovës

Shiriti dekorues sipas verifikimit dhe matjes është: 3.7cm

10.KRAVATA-MESHKIJ

Shiriti i përfundëshëm i kravarës sipas verifikimit dhe matjes është: 42 cm

Gjatësia komplet me nyje e kravarës sipas verifikimit dhe matjes është: 47 cm

11.KRAVATA-FEMRA

Gjatësia sipas verifikimit dhe matjes është: 36 cm

Gjerësia në anën e shkurtër sipas verifikimit dhe matjes është: 31.5 cm

Gjerësia në anën e pasme sipas verifikimit dhe matjes është: 2.4 cm

Gjerësia në anën e përparme sipas verifikimit dhe matjes është: 6.5 cm

Sipas verifikimit dhe matjeve (dimensioneve) të mostrave bazuar në pretendimet ankimore dhe duke krahasuar matjet dhe verifikimet edhe nga ana e ankuesit dhe mostrave nga OE nuk korrespondojnë të gjitha të sakta sipas specifikave teknike të kërkuara me % tolerance përjashtuar kualitetin, ngjyrat apo specifikimet tjera.

Vetëm një pjesë e artikujve janë sipas standardeve të kërkuara bazuar edhe në % tolerance (në cm, mm) të cilat janë të specifikuar në tabela sipas produkteve.

Përgjigje në pretendimi ankimor 15

Sa i përket këtij pretendimi të ngritur në lidhje me ngjyrën e mostrave e cila nuk është e njëjtë po ka dallime të mostrave të prezantuara, eksperti teknik sqaron se nuk është se ka vërejtur dallime në ngjyrën e mostrave. Në fotot e paraqitura mund të duket dallimi për shkak të ndriqimit. Konsideroj që ky pretendim nuk qëndron.

Përgjigje në pretendimi ankimor 16

Eksperti sqaron se sa i përket pjesës së kontratave të realizuara nga anëtari i grupit Seyntex, në listën e të cilës janë tre kontrata të realizuara, atëherë nëse merret vetëm kontrata e tretë e cila ka përfunduar brenda periudhës tre vjeçare të paraparë me dosje të tenderit dhe referenca e lëshuar për këtë kontratë sipas kërkesave, vlerësojmë që kjo kontratë është në përputhje me kërkesat e dosjes dhe e përmbush edhe kriterin e shumës së kërkuar, por nuk ceket emri se për kë është lëshuar kjo referencë. Ndërsa sa i përket pretendimit se referencat mund të jenë fiktive atëherë duhet theksuar se eksperti nuk është i thirrur për të vërtetuar se a janë këto referenca fiktive apo jo, por janë organet kompetente. Gjuha e përdorur në këto referenca ku aludohet se është e kombinuar me gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe ka të bëjë me titullin e prokurimit i cili është shkruar në gjuhën në të cilën edhe është njoftimi i kontratës. Sqarime shtesë për vërtetim të origjinalitetit të referencave siç janë transaksionet bankare mund të kërkojnë nga ana e autoritetit në rastin se ka dyshime në vërtetësinë e të dhënave, ndërsa sa i përket referencave të dorëzuara edhe eksperti njofton se në këto referenca gjenden datat, shumat dhe të dhëna të tjera por nuk tregohet se për cilin operator është lëshuar kjo referencë,

pra emri se kjo referencë është lëshuar për Seyntex nuk figuron askund në referencë. Po ashtu, eksperti sqaron se shumica e a-testeve të dorëzuara nga OE i rekomanduar janë të vitit 2021 dhe një pjesë e vogël e tyre edhe të vitit 2023. Ky pretendim konsiderojmë që është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimi ankimor 17

Kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që operatorët pjesëmarrës të dëshmojnë të hyrat e përgjithshme në tre vitet e fundit të paktën në minimumin prej 8,000,000.00 euro dhe që kjo duhet të dëshmohej përmes deklaratave vjetore të dorëzuara në ATK për vitet 2020-2022. OE i rekomanduar në ofertë ka dorëzuar raportet e audituara financiare dhe pas kësaj AK ka kërkuar që të dorëzohen edhe deklaratat vjetore të operatorit nga vend i themelimit, në përputhje me nenin 72 të LPP-së dhe pikës 10 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik. Të njëjtat janë dorëzuar përmes sqarimeve dhe për to janë dorëzuar edhe përkthimet përkatëse andaj ky pretendim vlerësojmë që nuk është i bazuar.

Përfundim:

Me datë 17/10/2023, AK në lidhje me sqarimet shtesë të drejtuara nga operatorët ekonomik në lidhje me kërkesën për ofrimin e a-testeve të vitit 2023 kishte kthyer përgjigje se këto kërkesa për të sjellur testet laboratorike të vitit 2023 janë në përputhje të plotë me LPP dhe RRPP. Më pas AK me datë 07/11/2023 publikon në platformën e-prokurimi, formularin- B54- Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, ku tek kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional në lidhje me kryejën e a-testeve në vitin 2023, largon kriterin e vitit se kur duhet të jenë të realizuara këto teste laboratorike. Ekspertët e kanë sqaruar edhe më herët që sipas tyre nuk është e pranueshme që për mostrat e kërkuara sipas specifikave të parapara teknike, ndër të tjera duke përfshirë gjatësinë, gjerësinë, lartësinë, peshën, qëndrueshmërinë e larjeve, temperaturën e larjes.. etj., specifikat të përcaktohen në vitin 2023 përmes publikimit të njoftimit për kontratë dhe për të njëjtat mostra, testet laboratorike të jenë të realizuara në vitin 2021. OE i rekomanduar është thirrur në faktin që këto teste janë realizuar më herët, pasi që del se mostrat për të cilat janë lëshuar këto a-teste të jenë të njëjta me specifikat teknike të paraqitura për këtë aktivitet prokurimi, por është parë që edhe një arsyetim i tillë nuk qëndron për faktin se siç është parë edhe nga matjet e realizuara nga eksperti teknik, disa prej specifikave nuk janë të njëjta dhe nuk janë në përputhje me specifikat e kërkuara përmes dosjes. Për specifikat e kërkuara së pari është përcaktuar parametri i kërkuar dhe pastaj për disa prej tyre është përcaktuar edhe një parametër/përqindje e devijimeve të lejuara nga ky parametër. Sipas matjeve të bëra për mostrat e OE i rekomanduar, eksperti teknik ka sqaruar se janë parë devijime edhe nga parametrat e lejuar, të cilat janë konsideruar si devijime të lejuara nga ana e AK-së sipas nenit 59 të LPP-së. Mirëpo ekspertët sqarojnë se devijim mbi devijim nuk është i lejuar sipas ligjeve në fuqi, pra në momentin kur përcaktohet një kufi i devijimit të lejuar, dhe edhe pas kësaj autoriteti thirret se përsëri është devijim i vogël, atëherë në rastin konkret bëhet shumë problematike të dihet se ku është kufiri se deri ku mund të lejohet të shkoj ky devijim, sepse konsiderojmë që devijim pas devijimit nuk duhet të lejohet dhe jo në shumë raste të artikujve siç ka qenë në rastin e operatorit të rekomanduar.


Nga ana tjetër, siç e kemi cekur edhe në pretendimet e mëparshme, operatorët ankues kanë mungesa në testimet laboratorike të dorëzuara ku shihet se nuk janë përfshirë të gjithë artikujt e kërkuar sipas specifikacioneve teknike, po ashtu është parë që për disa testime të lëshuara, laboratorët ku janë kryer këto testime nuk kanë qenë të akredituar sipas kërkesave të AK-së, po ashtu nuk janë dorëzuar as lista e fushëveprimit të certifikates e kërkuar sipas Ankesi 1.

Gjithashtu, kërkesat e vendosura në dosje te tenderit nga ana e Autoritetit Kontraktues kanë qenë shumë të paqarta. Në njërin anë përmes FDT-së, AK ka kërkuar që operatorët të dorëzojnë vetëm certifikatën se janë të certifikuar me standardin ISO 17025:2005 për kryerjen e a-testeve laboratorike, ndërsa në pjesën e Aneksi 1, AK shton kërkesa të cilat nuk janë përfshirë në FDT, duke kërkuara që testet e dorëzuara duhet të jenë nga laborator i akredituar dhe certifikuar me ISO 1025:2005, dhe nga operatorët duhet të dorëzohet lista e fushëveprimit të certifikatës, testet duhet të jenë të kryera për të gjithë artikujt, por prapë i lë kërkesat e paqarta, duke mos sqaruar se konkretisht a duhet të jenë operatorët e akredituar vetëm për ISO 17025 sipas FDT apo duhet të jenë të akredituar për secilin standard tjetër të secilës pjesë të secilit artikull. Siç e ka potencuar edhe njëri nga laboratorët përmes kërkesës sqaruese është shumë vështirë të gjendet një laborator i vetëm i cili është i akredituar për numrin e madh të të gjitha standardeve të cilat po i kërkon AK përmes testimeve. Pra, siç është e ditur ligji për prokurimin publik kërkon që autoritetet të paraqesin kërkesa të qarta, ndryshe kriteret kufizuese, diskriminuese, kritere të larta të cilat sjellin vështirësi të mëdha për operatorët e interesuar, kriteret të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve nuk janë të lejuara përmes ligjit të prokurimit, sidomos jo kritere të paqarta si në rastin e këtij aktivitet të prokurimit.


Duke marr parasysh situatën e krijuar, ku është e vështirë të bëhen vlerësimet e duhura në bazë të kriterëve ekzistuese dhe ecurinë e këtij projekti të përshkruar më lartë, ekspertët vlerësojnë që ky aktivitet prokurimi në këtë pikë duhet të anulohet.

*Disa nga fotot e realizuara nga eksperti teknik

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Sabit Makiqi B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE**” me numër të prokurimit: “**214-23-8647-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**




Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Sabit Makiqi B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE**” me numër të prokurimit: “**214-23-8647-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**




Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Sabit Makiqi B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE**” me numër të prokurimit: “**214-23-8647-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Sabit Makiqi B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE**” me numër të prokurimit: “**214-23-8647-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**




Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Sabit Makiqi B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE**” me numër të prokurimit: “**214-23-8647-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Sabit Makiqi B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE**” me numër të prokurimit: “**214-23-8647-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**





REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES


Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Sabit Makiqi B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE**” me numër të prokurimit: “**214-23-8647-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Sabit Makiqi B.I.**

Agnese Ibrahim



Zeni Ballazhi

